



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, ish-hotel “Drini”, Tiranë - Albania,

Tel/Fax: 04 2268141; 042268142

Nr. 1377/5 Prot.

Tiranë, më 28.07.2017

V E N D I M

Nr. 183, datë 28.07.2017

“Mbi verifikimin e ligjshmërisë të aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithëshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Bashkisë Kolonjë, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE

Me Urdhrin nr. 1377/1 prot, datë 18.07.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ përfunduar, me aktin nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, “Për transferim të përkohshëm” të nëpunëses *****.

Në zbatim të këtij akti, u krye hetimi i plotë administrativ, u administrua dokumentacioni i nevojshëm për trajtimin e plotë të rastit dhe më pas u vlerësua ligjshmëria e veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, në lidhje me transferimin e përkohshëm të nëpunëses ***** , në Njësinë Administrative “Çlirim”, (në përmbajtjen e aktit të transferimit nuk është përmendur konkretisht pozicioni i punës).

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast rezulton se, punonjësja ***** me aktin nr. 103, datë 06.06.2016, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, është emëruar në pozicionin e “Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Kolonjë, nëpërmjet procedurave të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil.

Me ndryshimet e strukturës së Bashkisë Kolonjë, rezultojnë se është suprimuar pozicioni i punës “*Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse*” dhe për këtë arsye, nëpunësja në fjalë nëpërmjet transferimit të përhershëm, ka kaluar në pozicionin e punës “*Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, pozicion të cilin ajo e ka pranuar me vullnetin e saj.

Aktualisht, rezultojnë se kjo nëpunëse është transferuar në një pozicion tjetër pune, pranë njësisë administrative “*Çlirimi*”. Duke mos qenë dakort me këtë lëvizje, të cilën e konsideron si të pa bazuar në ligj, ajo i është drejtuar Komisionerit, për të rregulluar ligjshmërinë e administrimit të shërbimit civil.

Nisur nga përmbajtja e aktit të transferimit, rezultojnë se baza ligjore i është referuar nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili rregullon institutin e transferimit të përkohshëm.

Në kushtet kur, njësitë e qeverisjes vendore, janë subjekte të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, transferimi i përkohshëm i një nëpunësi civil, si në rastin konkret, rregullohet në mënyrë të posaçme nga neni 48, i këtij ligji.

Konkretisht, në bazë të kësaj dispozite, nëpunësi civil, për interes të institucionit mund të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil, me një kohëzgjatje jo më shumë se 6 muaj gjatë dy viteve, ndërkohë që, në rastin kur veprimi është realizuar për të përmirësuar rezultatet e vetë nëpunësit, si dhe për arsye të tjera ligjore që parashikohen në këtë dispozitë, afati i transferimit nuk mund të jetë më shumë se 3 muaj gjatë dy viteve, por në të gjitha rastet, duhet ruajtur kategoria e pozicionit në shërbimin civil.

Në rastin që po shqyrtojmë, rezultojnë se nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në dispozitën e analizuar më sipër, pasi në përmbajtjen e aktit administrativ nuk është përcaktuar arsyeja e transferimit, afati i transferimit dhe pozicioni i punës, pas transferimit, çka do të thotë se për pasojë është zbatuar gabim ligji.

Mos përcaktimi i pozicionit të punës në aktin e përkohshëm të transferimit, krijon kushte për mosrespektimin e pikës 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili kërkon detyrimisht që të ruhet kategoria e nëpunësit civil, në rastin e zbatimit të kësaj dispozite.

Po kështu, rezultojnë se nuk është parashikuar edhe një prej elementeve të domosdoshme që duhej të përmbante akti, që është afati i transferimit, i cili është i kufizuar në këtë dispozitë, sipas arsyes, nga 3-6 muaj, për periudhën 2 vjeçare.

Në lidhje me respektimin e elementit kryesor të transferimit të përkohshëm, që është ruajtja e kategorisë së nëpunësit civil, konstatohet se kjo kërkesë thelbësore nuk është mbajtur parasysh nga ana e institucionit.

Në bazë të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pozicionet e punës në shërbimin civil ndahen në këto kategori, a) të lartë drejtues; b) të mesëm drejtues; c) të ulët drejtues dhe ç) ekzekutiv.

Në vijim të kësaj analize, pika 6 e kësaj dispozite, përcakton se, pozicioni “Përgjegjës sektori” (pozicion pune të cilin mbante nëpunësja në fjalë përpara transferimit), është pozicion i kategorisë së ulët drejtuese, ndërkohë që, pozicioni i punës, “specialiste finance, në njësinë administrative Çlirim” (informacion ky i dalë nga hetimi administrativ, sepse në aktin e transferimit nuk përmendet pozicioni i punës, ç’ka përbën një tjetër parregullsi), ku kjo nëpunëse është transferuar aktualisht, në bazë të pikës 7, të nenit në fjalë, është pozicion i kategorisë ekzekutive.

Si përfundim, për të gjitha arsyet që analizuam më sipër, rezulton se veprimi administrativ për transferimin e përkohshëm të punonjësës *****, duhet të klasifikohet se ka dalë në kundërshtim me ligjin material, për shkak të mosrespektimit të kërkesave të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Mosrespektimi i kritereve në një rast transferimi të përkohshëm, si ai i ruajtjes së kategorisë në shërbimin civil, përcaktimi i kohëzgjatjes së këtij transferimi, si dhe përcaktimi i motivacionit, në përputhje me kushtet e kërkuara nga dispozitat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në vështrim të nenit 109, germa d), të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, e bën aktin të paligjshëm.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 113 dhe 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, Kryetari i Bashkisë Kolonjë duhet të anulojë aktin administrativ nr. 191, datë 05.06.2017, të rikthejë punonjësën në pozicionin e mëparshëm të punës dhe nëse vlerësohet se është e nevojshme që të aplikohet instituti i transferimit të përkohshëm në këtë rast, të respektohen kërkesat e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu si është argumentuar më sipër .

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 109 germa d), 113 dhe 114 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenin 35 të Rregullores, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të anulojë aktin administrativ nr. 191, datë 05.06.2017, të nxjerrë prej tij, “Për transferimin e përkohshëm të punonjësës *****”, si një akt i dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të rregullojë pasojat, duke e rikthyer punonjësën në pozicionin e mëparshëm të punës.
2. Bashkia Kolonjë, të zbatojë vendimin brenda **15** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Kolonjë dhe kërkuesja *****.
4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të

nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA